

Nr. Prot. 2581, datë 17.06.2025

Nr. Prot. 253, datë 17.06.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDURIALE (DPPI)

DHE

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË STANDARDIZIMIT (DPS)

Kjo marrëveshje, lidhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

- **“Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale”**, me seli në: “Bulevardi Zhan D’Ark”, Prona nr. 33, Ish-Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri, regjistruar me Numrin Unik të Identifikimit të Subjektit (NUIS) K51726018J, me objekt veprimtarie si institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, detyrim që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ligji organik nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, neni 189, si dhe nga dokumente strategjike si: Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit në nenin 73 të saj, “Pronësia Intelektuale”. DPPI funksionon në formën e një agjencie autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, pranë ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), përfaqësuar nga Znj. Maria Solis Kapedani, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Komanduar, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si **“DPPI”**.

DHE



- **“Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit”**, me adresë në: Rruga “Reshit Çollaku”, (pranë ILDKPKI, Kati VI, Kutia Postare 98, Tiranë, Shqipëri, përfaqësohet nga Z. Riza Hasanaj, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si “DPS”).

DPS ushtron veprimtarinë e saj bazuar në Ligjin nr.9870/2008 “Për Standardizimin”, të ndryshuar dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit në nenin 75 të saj, “Standardizimi, metrologjia, akreditimi dhe vlerësimi i përpushmërisë”. Neni 8 i këtij ligji përcakton se Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është organizmi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë për hartimin, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve në të gjithë sektorët e ekonomisë. DPS është person juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë. Struktura dhe organika e DPS-së propozohen nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe miratohen nga Kryeministri. Aktualisht struktura e DPS është sipas Urdhërit nr.142 të Kryeministrit, datë 26.09.2023 “Për një ndryshim në Urdhërin e Kryeministrit nr.182, 26.12.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit”.

(veçmas do të quhen si “Pala” dhe bashkarisht si “Palët”)

Marrë në konsideratë sa më lart, palët bien dakord për kushtet dhe afatet si më poshtë:

PARIME TË PËRGJITHSHME

- a. Bashkëpunimi do të realizohet vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë funksionimin e të dy palëve të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi dhe kërkesat rregullatore në fuqi;
- b. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të çenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilës pale të marrëveshjes që rrjedhin nga legjisllacioni në fuqi, në bazë të të cilit janë krijuar dhe funksionojnë palët e marrëveshjes.
- c. Kërkesa për bashkëpunim dhe dhënie informacioni mund të mos plotësohet në këto situata:
 - i. Kur informacioni i kërkuar është në kundërshtim me ndonjë ligj apo akt që rregullon ruajtjen e konfidencialitetit;
 - ii. Kur kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë marrëveshje.

NENI 1

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Të krijohet një kornizë bashkëpunimi ndërmjet DPPI-së dhe DPS-së për:

- Nxitjen e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik përmes promovimit të pronësisë industriale dhe standardizimit.
- Harmonizimin e veprimtarive që lidhen me mbrojtjen ligjore të shpikjeve dhe aplikimin e standardeve teknike për produktet dhe proceset.
- Përmirësimin e ndërgjegjësimit të publikut dhe bizneseve lidhur me rëndësinë e të dy fushave.

- Trajnime për grupet e interesit mbi **zbatimin e standardeve dhe mbrojtjen e pronësisë industriale**.
- Fushata ndërgjegjësimi për rëndësinë e mbrojtjes së shpikjeve dhe përdorimin e standardeve.

NENI 2

BAZA LIGJORE

Ligji Nr. 9978, datë 7.7. 2008, “Për Pronësinë Industriale”, *i ndryshuar*.

Ligji Nr. 9870 “Për Standardizimin”, datë 04.02.2008, *i përditësuar*, si dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre.

NENI 3

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

- a. Informacion mbi të dhënat për shpikjet, patentat dhe standardet përkatëse, përveç kur ka konflikt dhe për aq sa e lejon ligji.
- b. Krijimi i bazave të përbashkëta të të dhënave në fushat që përputhen.
- c. Organizimi i trajnimeve të përbashkëta për stafin respektiv të institucioneve.
- d. Seminare për bizneset mbi lidhjen ndërmjet standardeve dhe mbrojtjes së pronësisë industriale.
- e. Fushata ndërgjegjësimi për subjektet ekonomike dhe akademike.
- f. Aktivitetet publike si panairë, ditë informuese, dhe botime të përbashkëta.
- g. Konsulencë për zbatimin e standardeve në produktet e reja të mbrojtura me patentë apo modele të vlefshme.
- h. Bashkëpunim në hartimin e politikave që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe teknologjik.
- i. Përputhshmëria me direktivat e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.
- j. Promovimi i secilës palë për aplikime, konsultime ose publikime.
- k. Çdo bashkëpunim tjetër me interes të ndërsjellë, për fushat e përgjegjësisë, që nuk është cituar më lart.
- l. Palët bien dakord që organizimi i veprimtarive me interes të përbashkët të kryhet në varësi të burimeve (njerëzore e financiare) aseteve dhe potencialit të disponueshëm nga secila palë.

NENI 4

KONFIDENCIALITETI

1. Përveç rasteve kur parashikohet me ligj ose nga një organ rregullator ose siç mund të kërkohet në mënyrë strikte për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, secila Palë do të

ruajë sekretin dhe konfidencialitetin dhe nuk do të përdorë, përhapë/zbulojë ose t'i bëjë të njohur ndonjë palë të tretë ndonjë informacion, që ka lidhje me objektin e marrëveshjes.

2. Klausola e mësipërme nuk zbatohet për informacionin që është bërë publik në mënyra të tjera, përveç shkeljes së kësaj klauzole ose ndonjë detyrë tjetër konfidencialiteti ose është marrë nga një palë e tretë pa shkelur këtë klauzolë ose është kërkuar të bëhet e ditur nga ligji.
3. Palët nuk do të lejojnë përdorimin apo dhënien e çdo informacioni ose dokumenti konfidencial për qëllime të tjera, nga ato të përmendura në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

NENI 5

INTERPRETIMI I MARRËVESHJES

1. Kjo Marrëveshje do të interpretohet duke marrë parasysh kushtet dhe afatet e saj në tërësi. Në çdo rast, çdo paragraf ose term që sjell paqartësi, do të interpretohet në kontekstin e të gjithë Marrëveshjes dhe në përputhje me qëllimin për të cilin palët lidhin këtë marrëveshje.
2. Për të gjitha çështjet që nuk përcaktohen shprehimisht në këtë Marrëveshje, zbatohen aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, të fushës përkatëse.
3. Nëse ndonjë parashikim në këtë Marrëveshje është i pavlefshëm, ose i pazbatueshëm, ky parashikim do të ndahet dhe të gjitha parashikimet e kësaj Marrëveshjeje, do të mbeten plotësisht në fuqi.

NENI 6

NDRYSHIMET E MARRËVESHJES

Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të ndryshohet dhe revokohet në çdo kohë nga palët. Çdo ndryshim apo amendim i kësaj Marrëveshjeje, është i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

NENI 7

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet apo paqartësitë që mund të lindin në kuadër të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, zgjidhen me mirëkuptim nga palët, në bazë të ligjeve përkatëse në fuqi.

NENI 8

GJUHA

Kjo Marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë dhe secila palë merr 1 (një) kopje respektive të marrëveshjes.



NENI 9

NJOFTIMET DHE KORRESPONDENCA

Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit sipas kësaj Marrëveshjeje, palët përcaktojnë personat e kontaktit dhe të gjitha komunikimet e palëve do të realizohen ndërmjet tyre, me përjashtim të rasteve, kur është rënë dakord ndryshe.

NENI 10

HYRJA NË FUQI DHE KOHËZGJATJA

1. Marrëveshja hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit për një afat të pacaktuar.
2. Palët mund të zgjidhin në mënyrë të njëanëshme këtë Marrëveshje nga efektet në çdo kohë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim palën tjetër.

PALET

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE (DPPI)

Përfaqësuar nga:

ZNJ. MARIA SOLIS

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
I KOMANDUAR**



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT (DPS)

Përfaqësuar nga:

Z. RIZA HASANAJ

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

